

dhe Jesú j i pyeti perserí: “Po ju ç’ thoni se jam unë?” Dhe Simón Pjetri u-përgjéq, edhe tha: “Ti je Krishti, i Biri i Perendise se gjalle.” Dhe Jesú j i tha: “Te lumte goja, Simón, i biri i Jonájt, se këtë gjë nuk e ta ka zbuluar nonjë njerí me mish e me gjak, po vete im-Atë, qe është në qell. Edhe unë po të them se ti je Pjetri, edhe mi këtë shkemp do ta ndertónj Kishen time; edhe forcat e Ferrit nuk e do ta rrezojnë dot; edhe do të jap kyçet e Mbretërisë se qellit; edhe ç’ të lidhesh mi dhënë do të jetë e lidhur në qell; edhe ç’ të zgjidhesh mi dhënë do të jetë e zgjidhur në qell.

KUNGATORJA

Fama e tyre u-perháp në tërë botën.

30. Mbledhja e të Dymbëdhjetë Apostujve të Shenjtes, të lavderuar dhe emershkelqyer.

PERLESHORJA E TË DYMBGDHJETËVE, T. III.

O Apostú j të Shenjtes, lútjuni Zotit tonë Jesú Krisht, tu falle shpírteve tona, ndjesën e mekátave.

TË KREMTET E KORRIKUT

1. Kozmáj dhe Damiani, Anargjëndet e Shenjtes dhe çudiberes.

PERLESHORJA E ANARGJËNDEVE, T. T. IV.

Shen Anargjende çudiberes, Kozmá dhe Da-

mián, vizitónani dhe sherónani; darovísht e mú-arte, darovísht pra épnajeni.

2. *Vendosja e Brezit te çemuar te Shen Marise ne Vllakerne.*

PERLESHORJA E BREZIT, T. T. IV.

Virgjereshe dhe Hyjlíndese, edhe mprojtj' e njerezise, i fale qytetit tent Kemishen dhe Brezin e trupit tent, si keshtjelle dhe si arme kunder gjithc armiqve, se u-shenjtcruan dhe mbetne te pacinúara, se me ty na çuditi edhe natyra dhe koha. Pra ty te lútemi, dhuró-i paqen dhe hirin pópullit, dhe shpírteve tona perdellimin e math.

3. *Jakinthi, Deshmori i Shenjte; Anatoli, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopojes.*

4. *Andreu, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kretes.*

PERLESHORJA E ANDREUT TE KRETES, T. IV, KANONA PISTEOS

Kanún i beses, edhe kor' e butesise, mesonjes i perkores, ndrite perpara besnikëve, me te verteten e púneve; perandáj i fitove me perunjesine te lartat, me varferine te pásurat. At' i lavde-ruar Peshkóp André, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

5. *Athanasí i Athonit, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E ATHANASIT TE ATHONIT, T. III, TIN OREOTITA

Engjejte lart ne qell, bene çudí me ty, si rrojte permi dhé, si nje njerí me trup, o Shenjt leftove

trimerísht me forcat e nëndhëshme; edhe i dermove krejt, ushterít' e demóneve, Krishti pra o Shen Thanás, me dhurata të pásura; mundimet t' i çperbleu o Atë, lutu pra gjithënjé për në.

6. *Sisój i Math, Ati ynë Oshenár.*

7. *Thomáj i Malese, Ati ynë Oshenár; Kirjakia, Deshmorja e Madhe.*

PERLGSHORJA E THOMAJT TË MALESE,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerísht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tënt, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitím, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Gëngjëjtë, o Shen Thomá i lumur lavdí me ty.

PERLGSHORJA E SHEN KIRJAKISE,
T. IV, KATEPELLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me zë të math po të therrët: Dhënter ty të desherónj, dhe nat' e dite të kerkónj, dhe kryqësohem dhe varrosem tok me Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, që të gëzohem tok me ty, edhe vdes për emrin tënt, që tok me ty të rronj në qell; po si një fli të shenjte prit-më mua që për ty sakrifikohem. Dëgjona lutjet, edhe shpëtoji, shpirtet tona prej vdekjes.

8. *Shen Prokopi, Deshmori i Math.*

PERLESHORJA E SHEN PROKOPIT,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojttje lot e mundím, kurorre të ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e të dobet; aý per né po të lutet o Krisht Perendí, të shpetohen shpirtet tona.

9. *Pankrati, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Tavromenise.*

10. *Te Dyzét e Pese Deshmoret e Shenjte te Nikopolis ne Armeni.*

11. *Shen Efimia, Deshmorja e Madhe.*

PERLESHORJA E SHEN EFIMISE,
T. III, THIAS PISTEOS

Besclúmurit i ngazellove, beseshtrémberit i turperove, Virgjcrësh' e bekuar e Zotit Krisht; se i pelqeve vendimet e Aterve, qe kishte bere Sinodi i káterte; o Shen Efimí, pra lutu perpara Zotit Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave.

12. *Prokli dhe Illari, Deshmoret e Shenjte.*

13. *Mbledhja e Krye-éngjellit Gabriél; Stefani Sabaiti, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN GABRIELIT,
T. IV, O IPSOTHIS

O gjenerál i ushterive të qellit, né shërbetoret e pavyer degjona, dhe mprona gjithënjé dhe nermjetó pa pushím, hap-i fletet mi të gjithë né, dhe mbulona me drite, né qe po të lútemi, dhe therre-

sim me besë; O Gabriél shpëtona me nxitim, prej çdo reziku, si prijës i Çngjësve.

PERLESHORJA E STEFANIT SABAITIT,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIJE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjës i besës dhe i perkores je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shëmbell e Kryepërfitërve, i urtë Shen Stefán, të gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perëndí, të shpëtohen shpirtet tona.

E DIELA E SHEN ATERVE

(Që më 13-91 të Korrikut)

PERLESHORJA E SHEN ATERVE, T. T. IV.

I përmilavdëruar je o Krisht Perëndí dhe Zot, që dergove permi dhé, Aterit tanë të shenjtit dhe i ndrite, dhe me atá na shpurre në besën e drejtë, dhe na tregove shpëtimin. O meshireplót lavdí më ty.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Brenda në shtatë ditë, e bëri Zoti botën, dhe ju në shtatë mbledhje, na regulluat fënë, o Ater të Sinódeve.

Një Perëndí dhe Zot, të ndarë në tre veta, të njëjshme nga substanca, dhe një Triní lëçititë, o Ater të Sinódeve.

Krishtin si Perëndí, dhe Bir të Perëndisë, dhe Fjalë të panismë, na çfaqte dhe na çpallte, o Ater të Sinódeve.

Shpirtin që frymesój, Profetët dhe Shenjtoret, si Perendí e çpallte, me Atin e me Birin, o Ater të Sinódeve.

LAVDI DHE TANI. Shtypte çdo heresí, dhe ujqet që perçanin, kopén' e Jesú Krishtit, i çkatterruat fare, o Ater të Sinódeve.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Múarte frymesím, prej Shpirtit edhe shkruat, Simbolin e Nikesc, për Kishen Orthodokse, o Ater të Sinódeve.

Kishen e Zotit Krisht, të Shenjt' e të Pergjithme, Një dhe Apostolike, e çfaqte dhe e çpallte, o Ater të Sinódeve.

Çfaqte një Pagezím, mi emrin e Trinisë, dhe Ngjalljen e pergjithme, dhe jetën e perfuntme, o Ater të Sinódeve.

LAVDI DHE TANI. Vírgjeren Shen Marí, që lindi Jesú Krishtin, Hyjlindese si Nënë, të Perendis' e çfaqte, o Ater të Sinódeve.

Ne Sherbesen e Mengjezit kendohen Troparet e zakonata të Tingellit që rastís.

SINAKSARI

Gjithë sot kujtojmë Aterit e Shenjte, që múarne pjesë në gjashtë Sinodet e para Ekumenike.

Me nermjetimet e Aterve të Shenjte, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpir-

tit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet sot i Larti prej Virgjereshes, Abakumi si Profét, e pá edhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjeresh' e pamartuar, Zotin e botes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besnikëve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen edhe Nencn Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kerccnimin me zjarr, e shkelne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e dcnuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithë njërezit, këceni me ngazellim tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Ængjajt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjte panaír te Kryezonjes Marí, dhe thërrisni: Ti je mé e lúmu-
ra, Virgjerësh' e kulluar Hyjlíndese.

DËRGIMËSORET, T. III, EPESKEPSATO

O Shen Ater te Kísheve, u çpallte dogmat pó-
pujve, dhe heretiket beselíq, i çkaterruat plote-
rísht; u falte pra besníkeve, ne qellin Mbretërine,
Parajsën e Ængjajtve.

Nermjetoni tok per né, Shen Ater te Sinódeve,
dhe ti o Zonje Shen Marí, perkrahna pranë Birit
tent; nga çdo dením shpetónani, na falni Mbretë-
rine, qellore te Zotit Krisht.

LAVDËRIMET, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Ater te Sinódeve, me diturinë mendore, dhe
me Shpirtin Tereshénjt, passi u-ndriçuat misti-
kerísht me hir; një Simból per besím, Ater bes-
mire, pervijoste hyjerísht per né, dhe e çfaqte
Zotin Krisht, te bashkenisme si Perendí; dhe te
bashkeqéneshme, ne Trinín' e Atit dhe Shpirtit
Shenjt; sipas Apostujve, vazhduat predikimet be-
scrísht, edhe leçitte plot me lavdí, dogmat e bes-
níkeve.

Ater te Sinódeve, me dritën tuaj mendore, dhe
me hir te Shpirtit Shenjt, nxúarte orákullin e
doktrínave; një simból fjale-pák, me kuptím te
thelle, proklamuat prej tribúnave, dhe prej gjit-
hë Kísheve, ju o Ungjillorë te Zotit Krisht; per-

mbajtes te tradítave, edhe kujdestare te dógmave; Zoti jua çfaqí, nga qelli dhe ne boten ju dergój, tua leçitni besníkeve, besen e Shenjtóreve.

Ater te Sinódeve, o kujdestare besnike, dhe barínj te grígjave, plot me zemerím kunder te paúdheve; cilindó ujk te lik, me shigjét' e dbuat, me hobén' e Shpirtit Tereshénjt, i handakoste krejt, gjith' armíqt' e Kishes se hýjeshme; dhe ranc si te vdékurit, dhe perdhé u-shtrine per gjithenjé; o Ater te Shenjte, te fjeshte sherbetore te Jesújt, o Ungjillore te dógmave, drita e besníkeve.

LAVDI, T. T. IV. Shoqeria e Aterve me nam, e thirrur dhe e mbledhur prej Kishes ne Sinód, caktój dhe çkoqiti dogmen e Trinise, me tri persona dhe natyre te perbashkme, dhe nje mistér te math te Theollogjise, nje At dhe Bir dhe Shpirt te perendishme. Pra u kendojme me besë, lumerrime levdónjese: Te Shenjte Kryeprifterínj, dhe ushtare te Zotit, edhe Engjej te shkelqyer; o yj te doktrínave, mi horizontin e dríteve; keshtjella ne Sión, qe nuke túndeni kurre; o aroma prej lúleve te Parajses; o goje te arta te Ungjillit; o nder i Sinódeve, te Nikés' e te Shtátave, nermjetoni gjithenjé, per shpirtet e lútesve.

TANI. E permibekuar je, o Hyjlíndese Virgjeshë. Te hymnojme, se prej Birit qe linde, Ferri u-roberua, Adami u-nduall prape, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe né múarme jete. Perandáj po hymnojme dhe therresim: I

bekuar je o Krisht Perëndí, qe e pelqeve keshtú lavdí me ty.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA

O mburónj' e patronditur e te Krishtéreve, nermjetare e palodhur e besníkeve, ver-u veshin mekatáreve me dhempsherí, se po te therresim beserisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjreshë: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe te lusin o Hyjlíndese.

APOSTULLI

I bekuar je, o Zot, o Perëndí i Aterve tanë. Se je i drejte ne te gjitha sa na ke bere.

Prej Letres se Palit per Titon.

Bir Tito, fjala esht e vertete, dhe dua te shiguroheni per ketó, se keshtú atá, qe e besojne Perendine, do te kujdesen te perparojne me vepra te mira, se ketó jane te mira dhe te dobishme per njerezit. Qendró lark nga bisedimet e kotta, nga gjeneallogjite, nga grindjet, edhe nga sherret ligjetare. Hiq dorë prej njeriut heretik, passi ta keshillósh per heren e pare dhe per heren e dyte, dyke ditur se aý esht i permbysur dhe i denuar prej vetiu. Kur te te dergónj Artemane a Tihi-kone, eja menjhere te píquemi ne Nikopole, se atjé kam vendosur ta shkonj dimrin. Dergoji perpara me nxitím Zenane ligjetarin dhe Apollone, dhe kujdesu qe te mos u mungonje asgjé. Le te mesojne edhe tanet te perparojne ne vepra te mi-

ra për nevojat e domosdoshme, që të mos jenë të papamet. Të gjithë atë, që janë bashkë me mua të përshëndoshin. Përshëndósh-i me besë të gjithë atë, që na duan. Hiri qoftë me ju të gjithë. Amín.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Ju jini drita e botës. Një qytét, i vendosur mi një mal, nukë munt të fshihet. Edhe kur e ndezin kandilin, nuk e vënë nënë shnikun, po përmi kandilerin, që t'u ndrite gjithë atyre, që ndodhen në shtëpi. Keshtë le të shkelqenjë drita juaj përpara njëresve që t' i shikojnë veprat túaja të mira, dhe ta lavdërojnë Atin tuaj, që është në qell. Mos pandehni se kam ardhur ta prish ligjen edhe profetët. Nukë kam ardhur ta prish po ta plotësoj. Se me të vërtetë po ju them, gjer sa të prishet qelli edhe dheu, dhe gjer sa të mbarohen të gjitha, asnjë jotë dhe asnjë vijë e ligjes nukë do të prishet. Aý, pra, që shkel më të vógelen prej ketyre porrosive, a i mëson njërezinë t' i shkelin, do të quhet më i vógeli në Mbreterinë e qellit; po cilidó, që i zbatón, dhe i predikón, aý do të quhet i math në Mbreterinë e qellit.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

14. Akilla, Apostulli i Shenjtes; Josefi Studiti, Ati ynë i Shenjte, kryepeshkopi i Thesallonikes.

PERLESHORJA E JOSEFIT STUDITIT,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIFE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mësonjës i besës

dhe i perkores je, se na ke ndritur si nje yll, dhe u-tregove si shembell e Kryepfisterve, i urte Shen Joséf, te gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

15. *Kiriku dhe Julita, Deshmoret e Shenjte.*

16. *Athenogjeni, Hierodeshmori i Shenjte.*

17. *Shen Marina, Deshmorja e Madhe.*

PERLESHORJA E SHEN MARINGS,
T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me ze te math po te the-rrét: Dhenter ty te desherónj, dhe nat' e dite te kerkónj, dhe kryqesohem dhe varrosem tok me Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe te gezohem tok me ty, edhe vdes per emrin tent, qe tok me ty te rronj ne qell; po si nje fli te shenjte prit-me mua qe per ty sakrifikohem. Degjona lutjet, edhe shpetoji, shpirtet tona prej vdekjes.

18. *Emiliani, Deshmori i Shenjte.*

19. *Makrina, Nena jone Oshenare, e motra e Shen Basilit; Diu, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN MAKRINGS,
T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nene pikerísht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqe per mesím, qe te çkujdésemi per trup, se shkon me nxitím, dhe te kujdésemi per shpirt, se eshte i pavdekur; pra shpirti yt po ge-

zohet tok me Engjëjts, o Shen Makrín' e lumur lavdí me ty.

20. *Shent Elliu Thesbiti, Profeti i lavderuar.*

O Engjell o Shent Ellí, i lavderuar Profét, ti je Parcréndesi, per ardhjen e Zotit Krisht; u-çfage me trup mi dhé, dhe prej qellit i dergove, Elisheut dhuraten, dhe largove sëmundjet, dhe spastrove leprozet, dhe na dhurón sherime, edhe ndjesen e mekátave.

THIRRTORET, T. I, TON URANION

Me qeren zjarr edhe flage Profetin Shent Ellí, prej dheut na e ngrite dhe ne qell na e shpure, o Zoti Krisht taní pra i prit, nermjetimet e tij per né, qe i kremtojme kujtimin me ngazellím, dhe me kenge brohorítese.

Perpara Zotit na shkove o Shent Ellí Profét, jo me termét te tmerrte po me reze te zjarrta, dhe gjithenjë ne qell me qere shetit, dhe me kuaj po fluturón, dhe nga Parajsa si díelli na ndriçón, dhe me zell nermjetón per né.

Me shpaten i çkaterrove paganet prifterínj, dhe shine krejt e preve me nje fjal' e nje lutje, dhe gunen Elisheut si trashcgím, ia leshove kur ngjítеше, me qeren zjarr edhe flage ne rete lart, Shent Ellí o Profét me nam.

LAVDI, T. II. Mblídhuni sot ketú, Profetet t' i kremtojme, Ellín' e Elisheun, qe na sherojne shpirtet, dhe luten gjithenjë per né.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

O Shent Ellí zellót, me qeren zjarr dhe flage, ne qellin fluturove, dhe Engjell na u-çfaqe, per here nermjetó per né.

Mbréterit i qertón, dhe pópujt' i ndriçove, dhe birin e se vese, e ngjalle me nje fjale, Profét o Shent Ellí me nam.

Lart fluturój ne qell, Profeti Shent Elliu, dhe gunen Elisheut, me hir me dysh ia fali, dhe lutet gjithenjë per né.

LAVDI DHE TANI. O Shent Ellí Profét, tok me Shen Elisheun, edhe me Shen Marinë, per kráhnani me lutje, per ndjesen e mekátave.

NDËNJËSORET, T. I, TON TAFON SU

Shkelqeve si nje yll, me nje qere prej zjarri, si Engjell permi dhé, me nje fryme qellore, i theve te verbúarit, i qertove te shtrémberit, si te parin pra, permi Profetet te njohim, dhe te lútemi, o Shent Ellí i trishlumur, shpetona prej tmérreve.

LAVDI DHE TANI. O Zonje Shen Marí, en' e zgjedhur e Zotit, na ngrer dhe na shpetó, né te mjeret qe humpme, ne pellk te deshperímeve, dhe ne pus te mekátave, se ti vetem je, shpetím per né mekatarët, ti je ndíhmese, edhe perkrahes' e forte, dhe mprojtj' e besníkeve.

Arrive me virtút, Perëndinë dhe Zotin, se rroj-te permi dhé, nje jetese qellore, dhe more prej Shpirtit Shenjt, dhuretín' e sherímeve, pra çuditerisht, e ngjalle djalin e vdekur, dhe ne qiëllin,

me qere zjarri u-ngjite, o Shenjt o Profét Ellí.

LAVDI DHE TANI. Si Nene te Jesújt, qe te gjithe te njohim, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né, ty te kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpetimtare ne ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

Meqéneqe nuke ka Ungjill te Mengjezit, kendohet me-njehere:

SHKURTORJA, T. II.

O Shent Ellí Profét, qe çpalle madheshtite, e Perendise sonë, dhe shi nga qelli zbrite, perhere nermjetó per né.

SHTËPIA

Kur Shent Elliu pá ligesine e njeriut edhe me-shiren e Perendise, u-zemërua dhe na qertó j shume rende, po eshte gatí te zbutet per atá, qe pendohen me bese, se aý perhere nermjetón per né.

SINAKSARI

Me njezét te ketí múaji, kujtojme fluturimin ne qell me nje qere te zjarrte prej Shent Elliut Thesbitit, Profetit te lavderuar.

Me nermjetimet e tij, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se

Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle bu-
zeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudít'
e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pa-
sosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te ken-
dojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón,
kurorczoji me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po
mishcrohet sot i Larti prej Virgjereshes, Aba-
kumi si Profét, e pá edhe tha me ze te math: Zot
i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lav-
dí: Ti o Virgjeresh' e pamartuar, Zotin e botes
qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne
peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen edhe
Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni tro-
kisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi
prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po
Krijetarit lart, dhe kerccenimin me zjarr, e shkel-
ne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me
ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zja-
rrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból
ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po
e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju
veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gjitha
jetet.

IX. Gjithë njérczit, kecení me ngazellím tek

drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Engjejt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panaír te Kryezonjcs Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmu-
ra, Virgjersh' e kulluar Hyjlíndese.

DERGIMCSORET, T. III, EPESKEPSATO

Me nje qere me flag' e zjarr, u-ngjite lart ne qiellin, o Shent Ellí Profét i Math, si nje Engjell plot me shkelqím; pra nermjetó per gjithc né, perpara Perendise, per ndjesen e fájeve.

Na linde o Hyjlíndese, Jesune Krishtin Perendí, qe tere boten e shpetójt, nga Ferri i demóneve; shpetona nga semundjet pra, nga helmet dhe mekatat, me lutjet e dhémpshura.

LAVDERIMET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

More o Profét o Shent Ellí, me vepra dhe me virtút, dhe me sjellje te ménçime, nje fuqí dhe nje lavdí, prej Zotit Perendí; dhe regullonje ngjarjet e kóheve, edhe natyren, ndronje me urdherím; shine e preve krejt, dhe prej qellit zbrite zjarr mi çdo armík; pranc Zotit nermjetó, dhe shpirtet na shpetó.

Zell dhe besc Zoti te dhurój, dhe te dergój si Profét, dhe qertove keq mbréterit, príncrit dhe prífiterit, dhe i dermove krejt; e ndeze zjarrin, n' ujen e gjóleve, dhe drithe kore, pa mbjellur árave; çave lumin Jordán, per Profetin Elishé dhe shkoj pertéj; pranc Zotit nermjetó, dhe shpirtet na shpetó.

Rrojte si nje Engjell permi dhé, dhe Perëndia të dha, pasurín' e dhurátave, per të bere çdo çudi, o Shent Ellí me nam; ia ngjalle djalin, gruas se ve me lot, me qere zjarri, hipe ne qiéllin; pra sot po mblídhemi, dhe të lútemi të gjithë pa pushím; prane Zotit nermjetó, dhe shpirtet na shpetó.

LAVDI, T. T. IV. Le t' i nderojme me kenge, Profetet e larte, dhe yjt' e ndriçim të botes, Elline dhe Elisheun, dhe le t' i therresim Krishtit me gas: O Zot meshireplót, me lutjet e Proféteve, dhuroji pópullit tent, ndjesen e mekátave, dhe perdellimin e math.

TANI, T. II. O Zonje Shen Marí, të lútemi degjona, dhe tok me Shent Elline, dhe me Shent Elisheun, perhere nermjetó per né.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besníkeve, ver-u veshin mekatáreve me dhempsherí, se po të therresim bescrisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjeshe: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe të lusin o Hyjlíndese.

APOSTULLI

Ti je prift per jete pas úrdherit të Melkishedeut. Zoti i tha tim-Zoti: Rri se djathti meje.

Prej Letres se Pergjithme të Jakobit.

Vellezer, mérrini Profetet, qe folne me emrin

e Zotit, si shembell të ligëvojtjes dhe zemërgjersise. Ja ku i quajmë të lumur atá, që durojnë. Kini degjuar për durimin e Jobit, edhe e kini parë fundin e Zotit, se Zoti është meshireplót dhe zemërdhempshur. Po përpara të gjithëve, o vellezer, mos u-betoni as për qellin as për dhënë, dhe mos bëni asnjë bë tjetër, po le të jetë poja juaj po, dhe joja juaj jo, që të mos bëni në denim. A vuan keq nonjë prej jush? Le të psalle. A është i sëmurë nonjë prej jush? Le t' i thërresë pleqt' e Kishes, dhe le të falen mi atë, dhe le të lyejnë me vaj me emrin e Zotit. Edhe urata e besës do të shpëtonjë të sëmurin, edhe Zoti do të ngrerë; dhe në pastë bërë mekata, do t' i falen. Refëjini fajet njerjatrë, edhe fáluni për njerjatrë, që të shëróheni. Lutja e vepruar e të drejtë ka fuqi të madhe. Elliu ishte një njeri, që vúante si në, dhe bëri një lutje që të mos bënte shi, dhe nukë ra shi mi dhënë tre vjet edhe gjashtë muaj, edhe u-fal përseri, edhe ra shi nga qelli, edhe mbinc përme nga dheu. Vellezer, neqóftëse nonjë prej jush largohet nga e vërteta, dhe dikúsh e kthen në udhën e drejtë, aý, i cili e ktheu mekatarin nga genjeshtra, duhet të dijë që shpëtó j një shpirt nga vdekja, edhe do të lanjë shumë mekata.

UNGGJILLI PAS LUKAJT

M' atë kohë, njërezit po çuditëshin për fjalët hirplote, që dilnin nga goja e Jesújt, edhe thoshnin: "A nuk është ky i biri i Josefít?" Edhe Je-

súj u tha: “Qe te gjithë do me thoni këtë para-
bollë: Mjek, sheroje veten. Ató, qe degjuam se
ke bërë në Kapernaúm, bëj-i edhe këtë në atdhe-
un tënt.” Edhe pastáj u tha: “Me te vertetë po
ju them qe nuk ka profét te mirëpritur në at-
dheun e vetë. Dhe me te vertetë po ju them:
Kishte shumë te veja në Israelin në kohën e Elli-
ut, kur qelli u-mbyll për tre vjet edhe gjashtë
muaj, edhe ngjau një zi e madhe në tërë vendin,
edhe Elliu nuk u-dergua me nonjë prej këtyre,
po në një grua të ve në Sareptë të Sidonës. Edhe
kishte shumë leprozë në Israelin në kohën e Eli-
sheut, edhe nuk u-paqësua nonjë prej këtyre, po
vetëm Neemani Sirián.” Edhe u-zemëruan qe te
gjithë në sinagojë, kur i degjuan këtë fjale, edhe
u-ngritën, dhe e nxúarnë jashtë qytetit, edhe e
prunë buzë malit, ku ishte ndertuar qyteti i tyre,
qe ta vervitnin tatepjetë. Po aý shkoj në mes të
tyre, dhe u-largua.

KUNGATORJA

Ngazellóhuni me Zotin, o të drejtë.

21. *Simeoni dhe Joani, Aterit tanë Oshenárë.*

PERLËSHORJA E OSHENARËVE, T. T. IV.

O Perëndí i Aterve, qe na sillesh gjithënjé, me
miresí dhe butesí, mos e kursé perdëllimin tënt
për né; me lutjet e Aterve tanë, qeveris-e jetën
tonë me paqe.

22. *Maria Magdalena, Myreprúresja e Shenjtë.*

PERLESHORJA E MARISË MAGDALENËS,
T. I, TON TAFON SU SOTIR

Pasove bescrisht, Jesú Krishtin qe lindi, prej Virgjerës Marí, o Marí Magdalens, dhe gjithë porrosít' e tij, dhe kanunet i rúajte, perandáj pra sot, kujtimin tent e kremtojmë, dhe të lútemi, të na dhurósh perdellimin, dhe ndjesen e mekátave.

23. Fokáj, Hierodeshmori i Shenjte; Jezekieli, Profeti i Shenjte.

PERLESHORJA E JEZEKIELIT, T. II.

Jezekiél Profét i Shenjte, qe të kremtojmë me besë, nermjetó perpara Zotit, të shpctohen shpirtet tona.

24. Shen Kristina, Deshmorja e Madhe.

PERLESHORJA E SHËN KRISTINËS,
T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me zë të math po të therrët: Dhenter ty të dësherónj, dhe nat' e ditë të kerkónj, dhe kryqsohem dhe varrosem tok me Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe të gëzohem tok me ty, edhe vdes për emrin tent, qe tok me ty të rronj në qell; po si një fli të shenjte prit-me mua qe për ty sakrifikohem. Degjona lutjet, edhe shpctoji, shpirtet tona prej vdekjes.

25. Fjetja e Shen Annes, nenes se Shen Marise.

PERLESHORJA E SHEN ANNGS, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Marine Hyjlíndese, Nenen e Zotit Krisht, Shen Anne hyjprúrcese, e linde ti per çudí, dhe u-ngjite ne qell me té, atjé ku po banojne, dhe defrejne Shenjtoret, Engjejte dhe Dëshmoret, prane fronit te Zotit; dhurona pra meshiren dhe ndjesen e mekátave.

26. Hermollau, Hermipi dhe Hermokrati, Hierodeshmoret e Shenjte; Shen e Premtja, Dëshmorja Oshenare.

PERLESHORJA E SHEN E PREMTE, T. I.

Pate zell sipas fteses qe lártazi, dhe u-mundove dhe vojte keq, dhe pas emrit dhe pas beses, ke trasheguar lavdí ne qell, o Shen e Premte Athlofore; pra na dhurón sherime gjithenjé, dhe nermjetón qe te shpctohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! O Shen e Premte me nam, o viktím' e pagáneve, qe dëshmove trimérisht, fitove lavdí ne qell; more çperblimin, rogen e vójtjeve, edhe kuroret, lulet e gjémbave; pra nermjetó per né, qe kremtojme beserisht kujtimin tent; prane Zotit Jesú Krisht, dhe shpirtet na shpetó.

Pate zell te fort' e mall te math, per Shpëtimtarin Jesú, o Dëshmore qe vúajte, me durím dhe triméri, çdo mundím edhe çdo kamçik; dhe kur te shempte, grusht' i katíleve, dhe kur te grinte,

shpat' e xheláteve, ti po mejtóheshe, per kuroret qe fitove lart ne qell; prane Krishtit nermjetó, dhe shpirtet na shpetó.

Vojtjet, qe durove s' thuhen dot, po s' u-trondite aspák, dhe qendrove me trimerí, ne kesh-tjellen e Jesújt, kunder gjithë demóneve; keshtú u-bere, shoqe e Engjcejve, dhe nus' e Zotit, lul' e Shenjtóreve; pra nermjetó per né, qe kremtojme beserisht kujtimin tent; prane Zotit Jesú Krisht, dhe shpirtet na shpetó.

LAVDI, T. II. Mblídhuni sot ketú, te gjithë ta kremtojme, Dëshmoren Shen e Premte, qe vojtje edhe ndriti, dhe lutet gjithënjé per né.

TANI. O Zonje Shen Marí, me Shen e Premten bashke, perkráhnani pa prere, perpara Jesú Krishtit, per ndjesen e mekátave.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Vojtje te tmérshime, durove po me Kryqin, Satanin e dërmove, dhe ídhullat i shove, o Shen e Premte me lavdí.

Zjarri s' te dogji dot, s' te shtypi dot as guri, se Engjelli te mprojtje, me flete dhe me vese, me úrdherin e Zotit Krisht.

Rrojte ne virgjëri, dhe shpirtin e ndriçove, kuroren e fitove, si nuse e Parajsës, dhe lutesh gjithënjé per né.

LAVDI DHE TANI. Kenge me brohorí, ken-dójini Dëshmoren, se lumur Shen e Premte, qe tok me Shen Marinë, perhere nermjetón per né.

NDENJCSORET, T. IV, O IPSOTHIS

Per Shpetimtarin dashurí dyke patur, e zbukurove shpirtin tent me virtuta, dhe me mundím' e dhembje dhe tortura pa funt, fluturove lart ne qell, dhe kurorë fitove, dasme pate me lavdí, si nje nus' e Parajses, dhe gjithenjë per né po nermjetón, qe te nderojme, o Shen e Premte e ndrícime.

LAVDI DHE TANI. Te perhirojme gjithenjë Virgjereshe, dhe te hymnojme pa pushuar prej zemre, per dhempsherine tende né besniket e tu, lútemi me ze te math: Nen' e Shenjte degjona, eja dhe shpetona shpejt, nga armiqt' e padukur, nga çdo pusí rezík dhe kerccním, se ti perhere, na mpron o Hyjlíndese.

T. I, TON TAFON SU

Si shqerre pa nje cen, ke jetuar ne bote, e ngri-te Kryqin tent, dhe Jesún' e pasove, me vojtje edhe me deshímím, ke fituar çdo bukurí, more hirin pra, per te sheruar semundje, dhe po na shpetón, nga dobesít' e lengatat, me forcen e Shpirtit Shenjt.

LAVDI DHE TANI. Si Nene te Jesújt, qe te gjithë te njohim, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né, ty te kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpetimtare ne ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

Meqéneqe nuke ka Ungjill te Mengjezit, kendohet me-njehere:

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS SIMERON

Kisha jote na sherón, nga çdo semundje, pra kctú po mblídhemi, edhe te lútemi me mall, dhe te therresim me ze te math: Eja shpctona, o Shen e Premte e ndrícime.

SHTËPIA

Si nuse e Parajsës dhe Dëshmore e kurorezuar, dhe Oshenare e lumur, kujtoji atá qe ta kremtojnë panairin, te mbledhur ne Kishen tënde, se ty te lavderojme me besë, dhe ty te therresim me ze te math: Eja shpctona, o Shen e Premte e ndrícime.

SINAKSARI

Me njezét e gjashtë te ketí múaji, kujtojme Shen e Premten, Oshenare dhe Dëshmore.

Gjithë sot, kujtojme Hermollanë, Hermippin dhe Hermokratin, Hierodëshmoret e Shenjtë.

Gjithë sot, kujtojme Ignatin Stironitin, Atin tone Oshenár.

Gjithë sot, kujtojme Shen Appionin dhe Shen Jerusalemin.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kengë do t' i kendónj, Nenes se

Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle bu-
zqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudít'
e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendisë, burím i pa-
sosur jetësór, ti shiguroji gjith' atá, qe te ken-
dojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón,
kurorëzoji me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmësúarin pllan perëndór, qe po
mishcrohet sot i Larti prej Virgjreshes, Aba-
kumi si Profét, e pá edhe tha me ze te math: Zot
i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lav-
dí: Ti o Virgjresh' e pamartuar, Zotin e botes
qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne
peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen edhe
Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni tro-
kisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi
prej asáj.

VII. Nuk u fálcshin, krijésave hyjméndesit, po
Krijetarit lart, dhe kercenimin me zjarr, e shkel-
ne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me
ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zja-
rrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból
ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po
e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju
veprat e Zotit, dhe e lartesoni permi te gjitha
jetet.

IX. Gjithë njërczit, kcceni me ngazellím tek

drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Engjëjt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panair te Kryezonjcs Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmu-
ra, Virgjersh' e kulluar Hyjlíndese.

DERGIMESORET, T. II, TIS MATHITES

Fitove forcë pa kufí, me Kryqin e çemuar, the-
ve ordít' e érreta, dhe tiranín' e Ferrit, edhe
deshmove me vojtje, dhe me mundime te renda,
pra Zot' i Math te vleresój, per kurorc lavdie dhe
lumerí, dhe fitove jeten e pambaruar, Parajscn
e Shenjtóreve, Dëshmore Shen e Premte.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo re-
ziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo
nevoje, dhe mos na ler te na marre, djalli ditën
e funtme, as Ferr' i erresírave, mprona perpara
gjqit te Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgje-
reshc, si Nen' e Zotit ti i ke, qe te gjitha ne dore.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Nepcr hoborret e Zotit po vallezon taní, me
shoqet virgjresha, me te urtat e dheut; atjé ke
marre hirin per çdo çudí, dhe sherím te semúnd-
jeve, pra nermjetó pranc Zotit dhe na shpetó, né
besniket qe te lútemi.

Dermove gjithc taboret e te pabéseve, me be-
sen e Perendisc, Shen e Premte Dëshmore, s' u-
trembe as nga flag' e zjarrit qe djek, as nga
çpojtjet e plúmbave, as nga kamçiket as nga
újcrat ne kazán, as nga presa e shpátave.

Dyke munduar kufomen e ndrite shpirtin tent, Deshmór' e Shpetimtarit, Shen e Premte e lumur, dhe dolle si u-trete brenda ne zjarr, m' e kulluar posi flori, dhe more lart kurore dhe lumeri, ne Parajsen e Shenjtórove.

LAVDI, T. II. U-vendose ne qytetin e Perendise, ne brëgun e shenjtc Sión, dhe e mbajte driten te pashuar. Le ta lavderojme pra Virgjreshen. O virgjcri o tempull i Perendise, o virgjcri o lavdi e Deshmórove, o virgjcri o shoqe e En-gjejve.

TANI. Çdo shprese me ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj perhér' e ti me mpro.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e te Krishtërove, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekatárove me dhempshcri, se po te therresim beserisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjreshc: Ndhna me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe te lusin o Hyjlíndese.

APOSTULLI

Si do tja çpaguejme Zotit te gjitha te mirat?
Do tja drejtónj te lúturat e mia Zotit.

Prej Letres II se Palit per Timotheun.

Bir Timothé, vigjelló per te gjitha, váaj-i te keqiat, bëj-e vepren e Ungjillorit, edhe mbaroje sherbimin, se une po shkrinj, dhe me ka ardhur

koha që tju le shendet. E leftova luften e mire, e mbarova rendjen, e rúajta besen. Taní me pret kurora e drejtesise, te cilen do ma japë Zoti, gjykátesí i drejte, m' até dite, dhe jo vetem mua, po edhe te gjith' atyre, që e duan fanesjen e tij.

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti u tha Dishépujve: Kjo është porrosia ime, doni njerjatin. Neqóftese bota ju urrén, díjeni se mua me ka urryer mé pare se ju. Sikur te ishit prej botes, bota do tju deshte si te sajte, po meqéneqe nukë jini prej botes, nga e cila ju kam zgjedhur une, perandáj bota ju urrén. Kujtójeni fjalen, që ju thashe. Nukë ka sherbetór mé te math se i Zoti. Atá, që me kanë ndjekur mua, do tju ndjekin edhe ju. Atá, që kanë rúajtur fjalen time, do ta rúajne edhe túajen. Edhe ketó te gjitha do tju bëjne per emrin tim, se nuk e njohin até, që me ka derguar. Sikur te mos kisha ardhur dhe te mos u kisha folur, nukë do te kishin mekát. Po taní nukë kanë mehanë per mekatin e tyre. Aý, që me urrén mua, urrén edhe tim-Atë. Sikur te mos kisha bere perpara tyre veprat, te cilat nuk i ka bere asnjé tjater, nukë do te kishin mekát, po taní edhe i kanë pare veprat edhe me kanë urryer edhe mua edhe tim-Atë. Edhe keshtú mbushen fjalet e shkrúara ne ligjen e tyre, që me urryen darovísht. Edhe kur te vinje Ngushellimtari, Shpirti i se vertetes, që dergohet prej Atit, te cilin do tju dergónj une me anen e Atit, aý do te deshmonje per mua. Po edhe ju deshmo-

ni, se kini qene me mua qe ne krye. Ketó jua thashe, qe te mos skandalizoheni. Do tju nxierin jashte sinagójave, edhe vjen ora, ne te cilen atá, qe do tju vrasin, do te mburren se i bene nje sherbím Perendise.

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

27. *Shen Pandelimoni.*

PERLGSHORJA E SHEN PANDELIMONIT, T. III.

O i Shenjte Athlofór, Pandelimón sheronjes i lumur, lutju Perendise meshireplót, t'u fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

O Shen Pandelimón, Deshmór i Math i Krishtit, qe u-kurorezove, ne Mbretérin' e qellit, dhe lutesh gjithenjé per né.

Nenes i vajte pas, dhe atin e fitove, per fen' e Shpctimtarit, dhe vojte dhe deshmave, dhe lutesh gjithenjé per né.

Hirin e Shpirtit Shenjt, e more me mundime, dhe na dhurón sherime, semundjesh dhe lengatash, dhe lutesh gjithenjé per né.

LAVDI. Mblídhuni sot ketú, te gjithë ta kremtojme, Pandelimón' e Shenjte, qe na sherón lengatat, dhe lutet gjithenjé per né.

TANI. O Zonje Shen Marí, me Shen Pandeli-

monin, përkráhnani pa prerc, përpara Jesú Krishtit, për ndjesen e mekátave.

PASVARGJET, T. I, TON URANION

Sot po kremtojmë me bujë dhe gas kujtimin tent, Pandelimón i Shenjtë, që dëshmove për Krishtin, dhe more hir shërimesh dhe na shpëtón, nga lengatat e tmërrshime, dhe nermjetón pranë Zotit për gjithë né, për shpëtimin e besnikëve.

Kerkove hirin që deshe me zëmër dhe me shpirt, pas ndjënjave të tua veperove në jetë, u-bere mirëbërës dhe shërimtár, i atyre që vújane, edhe shëndetin besnikëve u dhurón, me ilaçet e Zotit Krisht.

Mundimet që ke duruar me gojë s' thuhën dot, Pandelimón i Shenjtë, o Dëshmór i degjuar, se vajtje pa kufi i dhé trupit tent, edhe Ferri s' të trembi dot, se kishe mall për shpëtimin e Zotit Krisht, dhe Parajscën e Shenjtórcëve.

LAVDI DHE TANI, T. II. O Shen Pandelimón, pas nënës ndrite atin, me fen' e Krishterimit, dhe na shëron lengatat, dhe lutesh gjithënjë për né.

NDËNJËSORET, T. I, TON TAFON SU

Pasove besërisht, nënen tënde të lumur, dhe atin tent pagán, pranë Krishtit e shpëruar, pra more hir që lartazi, për shërimin e vójtjeve, dhe sëmundjeve, të njerczisë që vuan, o Dëshmór i Math, o Mjek i besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Si Nene te Jesújt, qe te gjithë te njohim, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né, ty te kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpetimtare ne ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

T. IV, O IPSOTHIS

Ty o ushtár i patronditur i Krishtit, dhe kryetrím i Kishes sonë se Shenjte, te lavderojme sot me brohorí dhe gezím, o Dëshmór dhe Mjek i Math, per lengatat dhe vojtjet, Shen Pandelimón me nam, i degjuar ne bote, perpara Zotit lutu gjithënjé, edhe dhuroju, shpetimin besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Te perhirojme gjithënjé Virgjereshe, dhe te hymnojme pa pushuar prej zemre, per dhempsherine tende né besnikët e tu, lútemi me ze te math: Nen' e Shenjte degjona, eja dhe shpetona shpejt, nga armíqt' e padukur, nga çdo pusí rezík dhe kercením, se ti perhere, na mpron o Hyjlíndese.

T. IV, EPEFANIS SIMERON

Diten tende kremterón, e tere bota, dhe mundimet pa tregím, qe ke duruar trimerísht, Pandelimón o Dëshmór i Math, o Mjek i Shenjte, i gjithë semúndjeve.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe mprojtëse, per çdo nevoje, nermjetó per gjithë né, qe kemi shpresë permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besnikëve.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione me lehtëjone, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turperoheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë kriesen për jetelindje.

PARËVARGU. I drejti do të lulezonjë si feník, dhe do të rritet si dellinja e Libanit.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS LUKAJT

Zoti u tha Dishëpujve: Rúaajuni nga njërezit, se do tju kapin, dhe do tju ndjekin, dhe do tju dorëzojnë nëpër sinagoja dhe nëpër burgje, dhe do tju shpien përpara mbréterve dhe princërve për emrin tim. Dhe kjo do tju bëhet për deshmím. Vëndosni pra në zemrat túaja të mos përemejtoni se qysh do të mpróheni, se unë do tju jap gojë dhe urtesí, të cilën nukë do të mundin ta përballin kundërshtaret tuaj. Dhe do të dorëzoheni edhe prej princërve dhe vellëzërve dhe gjirinjëve dhe miqve, edhe disa prej jush do të vriten, dhe do të jini të urryer prej të gjithëve për emrin tim, po asnjë qimë e kokës suaj nukë do të humbasë. Do ta zoteroni shpirtin me durimin tuaj.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Athloforit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. II. O Shen Pandelimón, pas nenes ndrite atin, me fen' e Krishterimit, dhe na sherón lengatat, dhe lutesh gjithenjé per né.

SHKURTORJA, T. T. I, TON SINANARKHON

Imitove leçitesin e meshírave, edhe si more dhuraten e çudibérjeve, o Deshmór i Math o Shen Pandelimón, Mjek u-tregove dhe sherón, çdo lengatë dhe mjerím të pópullit të semure, edhe lutesh perpara Zotit, per shpetimin e besníkeve.

SHTËPIA

Le ta nderojmë kujtimin e Mjekut Anargjént edhe kryetrimin me nam, që të marrim meshire per shpirtet edhe sherím per trupet. Le të rendim pranë tij me shigurí, se aý sherón çdo lengatë dhe mjerím të pópullit të semure, dhe lutet perpara Zotit per shpetimin e besníkeve.

SINAKSARI

Me njezét e shtatë të ketí múaji, kujtojme Shen Pandelimonin, Mjekun dhe Deshmorin e Math.

Gjithë sot, një i verber, i sheruar prej Shen Pandelimonit, e mbarój jeten i vrarë me shpatë.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. II, KHORI ISRAIL

(Kendohen qe me 27-31 te Korrikut)

I. I shenjt' Israél shkoj Detin e Kuq, si nonjë steré, me kembë të palágura, dhe armiqtë me kuaj u-pane ner valat, të mbytur të çkaterruar, pra me gas kendonte pópulli: O Perendí o Zot i Math, nder dhe lavdí me ty.

III. Arku i të fórtëve u-çthur, edhe u-forcua potera e të pafuqíshmeve, perandáj pra u-shigurua zemra ime permi Zotin lart.

IV. Kam degjuar pllanin tent për të shpetuar njërezit, o Krisht Perendí; lindi mi dhé prej Virgjërshes, qe të na çfaqësh driten e Ungjillit tent: Zoti i fuqishim lavdí me ty.

V. O Zot i Math qe ndriçove erresiren e vjeter, në drite veprat të lavderojnë o Krisht, me driten tende udhët tona drejtónaji.

VI. Nëpër hidherime, i thirra Zotit lart në qell, dhe ma priti lutjen Perendia i shpetimit tim.

VII. Në Babillone në zjarr, Djemat Abrami-anc, e shkelnë flagën përvëlónjese, dhe kendonin beserísht: O Perendí edhe Zot je i bekuar.

VIII. Tre Djemat në Babillone, me një zell qëllór të përdjegur, tiranin s' e përfilln' aspák, e shkelnë zjarrin burrerísht, edhe të vesuar prej qellit, të kendonin me zë të math: Zotin qe të gjitha kriesat e Zotit bekójeni.

IX. Pas lindjes qendrove Virgjereshe; dhe nje Perendí prej gjirit tent i misheruar, mi dhene na u-çfaq, edhe me njerës u-shoqcrua, pra te madheshtojme te gjithë o Hyjlíndese.

DËRGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Pandelimón Dëshmór i Math, Anargjént i nderuar, o Mjeku i besnikëve, qe sheron çdo lengate, dhe semundje dhe vojte, nermjetó pranë Zotit, qe tu dhuronje njérsve, paqen edhe meshiren per gjithenjé, sot qe ta kremtojme ditën me buje, me lutjet e Hyjlíndesës, dhe shpetona te gjithë.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na ler te na marre, djalli ditën e funtme, as Ferr' i errësírave, mprona perpara gjyqit te Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgjereshe, si Nen' e Zotit ti i ke, qe te gjitha ne dore.

LAVDËRIMET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU

Zotin Shpetimtár meshireplót, ke imituar mi dhé, veprave pas emrit tent, Shen Pandelimón me nam, o Dëshmór edhe Mjek i Math; i zemerdhempshur, rent pas te mjéreve, edhe pa roge, fal çdo sherim kudó; pra nermjetó per né, qe kremtojme bescrisht kujtimin tent; pranë Zotit Jesú Krisht, dhe shpirtet na shpetó.

Ndrite me çudit' e véprave, edhe provove kudó, qe je nxenes i Zotit Krisht, per shpetimn' e shpírteve, dhe shcrimin e trúpeve; Dëshmór i lumur,

Mjek i besnikëve, që ke perndarë, hir dhe shëndet kudo; pra nermjetë për në, që kremtojmë besërisht kujtimin tënt; pranë Zotit Jesu Krisht, dhe shpirtet na shpëtë.

Çfaqë bukurinë e shpirtit tënt, si dhe të trupit kudo, sqojtesinë e mejtímeve, dhëmpsherinë e ndjënjave, lartësinë e dëshirave; dhe sa të panë, Zotit i fálëshin, se u shërrove, vajtjet e trupeve; pra nermjetë për në, që kremtojmë besërisht kujtimin tënt; pranë Zotit Jesu Krisht, dhe shpirtet na shpëtë.

LAVDI, T. IV. Sot na ndriti kujtimi i Athloforit. Ejani të defrejme shpirtërisht, edhe të kurorëzjme me këngë; se e mundi armikun e padukur, burrërisht me Kryqin; dhe nuk u-tremp nga mundimet, po e fitoj kuroren e Dëshmorit, edhe tanë gëzohet për jetë me Gëngjëjtë. O Dëshmorë i Krishtit, o Shen Pandelimonë i lumur, Mjeku i të semurëve, dhe limanë i dimëronjesve, nermjetë pa pushuar përpara Zotit, të shpëtohen shpirtet tona.

TANI. Rujaji shërbëtorët e tu, prej gjithë rezikëve, o Virgjëreshë e bekuar, se ty të lavderojme, dhe ti je shpësa e shpërteve tona.

SHKURTORJA, T. R, EPI TU ORUS

Përmë malin ndrove fytyrën, edhe e panë lavdinë tëndë Dishëpujtë, o Krisht Përendi siç e merrnin vesh, dhe kështu kur të panë përmë Kryq pastaj, kupetuan që ishte pësim vullnetar,

dhe leçitne kudó mi dhé, se ti je vertét o Zoti Krisht, agullimi i Atit.

APOSTULLI

I drejti do të gëzohet me Zotin. Dëgjoma zerin, o Perendí.

Prej Letres II së Palit për Timothene.

Bir Timothé, forcohu me hirin e Jesú Krishtit, edhe ató, që ke dëgjuar prej meje, me shume deshmore, ua dorëzò njëresve besnike, të cilet janë të zotet tua mesojne edhe të tjerëve. Edhe duroji të keqiat, si ushtár i mirë i Jesú Krishtit. Asnjé njerí, i cili vete ushtár, nukë ngatërrohet në andrallat e jetës, po perpiqet t' i pelqenjë gjenëralit të vetë. Dhe askúsh nuk e fitón kurorën e trimerisë veç neqóftese trimerón pas ligjes. Bujku, i cili mundohet, ka të drejte të marrë një pjesë të pëmeve i pari. Kupetoi ató, që them, edhe Zoti të dhente ment për të gjitha. Kujtoje Jesú Krishtin prej fares së Davidit, i cili u-ngjáll së vdékuresh pas Ungjillit tim, për të cilin vuanj të keqia gjer në burk si nonjë keqberes, po fjala e Perendisë nukë lidhet me vargónj. Perandáj, i durónj të gjitha për të zgjédhurit, që të gjejne edhe atá shpëtimin e Jesú Krishtit edhe lavdinë e pasosur.

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti u tha Dishépujve: Kjo është porrosia ime, doni njerjatin. Neqóftese bota ju urrén, díjeni se mua më ka urryer më parë se ju. Sikur të ishit

prej botës, bota do tju deshte si te sajte, po me-
 qëneqë nukë jini prej botes, nga e cila ju kam
 zgjedhur unë, perandáj bota ju urrën. Kujtójeni
 fjalën, që ju thashe. Nukë ka sherbetór mé te
 math se i Zoti. Atá, që me kanë ndjekur mua, do
 tju ndjekin edhe ju. Atá, që kanë rúajtur fjalën
 time, do ta rúajnë edhe túajen. Edhe ketó te gji-
 tha do tjua bëjnë për emrin tim, se nuk e njohin
 atë, që me ka derguar. Sikur te mos kisha ardhur
 dhe te mos u kisha folur, nukë do te kishin me-
 kát. Po taní nukë kanë mehanë për mekatin e ty-
 re. Aý, që me urrën mua, urrën edhe tim-Atë. Si-
 kur te mos kisha bërë përpara tyre veprat, te ci-
 lat nuk i ka bërë asnjé tjtër, nukë do te kishin
 mekát, po taní edhe i kanë parë veprat edhe me
 kanë urryer edhe mua edhe tim-Atë. Edhe keshtú
 mbushen fjalet e shkrúara në ligjën e tyre, që
 me urryen darovísht. Edhe kur te vinjë Ngu-
 shellimtari, Shpirti i së vertetes, që dergohet prej
 Atit, te cilin do tjua dergónj unë me anën e Atit,
 aý do te deshmonjë për mua. Po edhe ju deshmo-
 ni, se kini qenë me mua që në krye. Ketó jua tha-
 she, që te mos skandalizóheni. Do tju nxíerin
 jashtë sinagójave, edhe vjen ora, në te cilën atá,
 që do tju vrasin, do te mburren se i bënë një sher-
 bím Perendisë.

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet për jetë.

*28. Prokori, Nikanori, Timoni dhe Parmenáj, Apos-
 tujte dhe Dhjaket e Shenjte.*

29. *Kaliniku dhe Theodota, Deshmoret e Shenjte.*
30. *Silla, Silluani, Kreskenti, Epeneti dhe Androniku, prej te Shtatedhjete Apostujve te Shenjte.*
31. *Evdokimi i Shenjte dhe i Drejte.*

TE KREMTET E GUSHTIT

1. *Shetitja e Kryqit ne Kostandinopoje; te Shtate Djemat e Shenjte te Makabenjve, e jema e tyre Sollomona, dhe mesonjesi i tyre Eleazari.*

2. *Trasferimi i lipsanit te Shen Stefanit, kryedhjakut edhe Deshmorit te Pare.*

PERLGSHORJA E SHEN STEFANIT, T. IV.

Kurore prej Mbreti ke, mi kokcn o Shen Stefan, per vojttjet e tmerrshime, per Zotin tone Jesus, i Par' i Deshmoreve; se ti i kallcove marresit' e Judenjve, dhe e pe Shpetimtarin, me te djathten e Atit. Atje pra nermjetó gjithenjé, te shpetohen shpirtet tona.

3. *Isaazi, Dalmati dhe Fausti, Aterit tane Oshenare.*

4. *Te Shtate Djemat e Shenjte te Efeses.*

5. *Parekremtja e Shperfytyrimit; Eusigni, Deshmori i Shenjte.*

6. *Shperfytyrimi (Shen Sotiri).*

PERLGSHORJA E SHPERFYTYRIMIT, T. R, METEMORFOTHIS EN TO ORI

Ndrove fytyren permi malin o Krisht Perendí, ndrite si nje Mesí per Dishépujte, ashtú sic merrnin vesh. Çfaq-e dhe per né driten me lavdí, qe ndrit ne qellin gjithenjé, me lutjet e Shen Marise, Dritedhenes lavdí me ty.